



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, al. 1, pika "b" të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19, al.1, pika "b" të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2004 merr

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e e objektit të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objekteve, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 2805/1 Zona kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe përafërsisht prej 80 ari.

Neni 3

Destinimi i caktuar i lokacionit, sipas këtij Vendimi, do të inkorporohet në Planin e ardhëshëm rregullativ të Qendrës Klinike Universitare të Prishtinës.

Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit për lokacion, lëshimin e lejes urbanistike, dhe lejinin e ndërtimit të objektit investiv, për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre, të caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. NR.353-3382 DT. 07.12.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri